VENDIM
Nr. 270, datë 2.5.2019

PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MISIONIN E KOMBEVE TË BASHKUARA NË SUDANIN E JUGUT (UNMISS)

(Ndryshuar me VKM nr. 403, datë 20.5.2020; nr. 895, datë 18.11.2020; nr. 461, datë 30.7.2021; nr. 579, datë 31.8.2022; nr. 371, datë 21.6.2023, nr: 595, datë 18.10.2023; nr. 445, datë 3.7.2024)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikave 2 e 5, të nenit 6, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të aktit normativ me fuqinë e ligjit, nr. 1, datë 20.3.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS)", miratuar me ligjin nr. 23/2019, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrja e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në Shtabin Rajonal të Forcës Mbrojtëse të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Juba, si dhe në Shtabin e Komandës Bor, Jonglei, në Republikën e Sudanit të Jugut, do të ketë një kohëzgjatje deri më 15.3.2027. Afati i misionit fillon të llogaritet nga data e dërgimit në mision. Periudhës së qëndrimit në mision i shtohen edhe ditët e qëndrimit për marrje e dorëzim detyre dhe të vonesave të transportit strategjik për ndërrimin me personelin e radhës .

2. Statusi i personelit pjesëmarrës të Forcave të Armatosura është sipas Marrëveshjes së Statusit të Forcave (SOFA), të datës 8 gusht 2011, ndërmjet Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe qeverisë së Republikës së Sudanit të Jugut.

3. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

a) dietat për ditët e qëndrimit, në masën *12 000 (dymbëdhjetë mijë)* lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) transportimin për në atdhe të individëve të shkëputur të misionit në rast vdekjeje, sëmundjeje, pamundësie për të përfunduar misionin ose thyerje disipline;

ç) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

4. Transporti për në atdhe i individëve të shkëputur nga operacioni në rast vdekjeje, sëmundjeje, pamundësie për të përfunduar misionin ose thyerje disipline do të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, përveç rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe, ku pala/palët tjetër/e tjera të marrë/marrin përsipër të përballojë/përballojnë këto shpenzime.

5. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR